

## 9.1 ADETIV PËR NGJITËSAT E PLLAKAVE

FLEXIT



Njësia matëse	Copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
1kg / bidon	12cp / kuti	1-3 kg / 25kg produkt	E bardhë
5kg / bidon	4cp / kuti	--	--
10 kg / bidon	60cp / paletë	--	--



### FLEXIT

Është një produkt me përmbajtje elastomerike i cili përdoret si një aditiv në ngjitësit dhe llaçrat me bazë çimentoje, si edhe tek hidroizoluesit një-komponentësh duke ju dhënë atyre vetitë e mëposhtme:

- Flexibilitet të lartë.
- Papërshkueshmëri ndaj ujit.
- Aftësi ngjitëse të përmirësuar.

### FUSHA E PËRDORIMIT

Flexit përdoret si elastifikues në rastet e mëposhtme:

- Në hidroizoluesit njëkomponentësh të aplikueshëm me furçë si (MONOFLEX), në rastet kur sipërfaqja ku do të aplikohet shfaq çarje ose plasaritje.
- Në ngjitësit e pllakave (DW), për shtrimin e pllakave mbi sipërfaqe të cilat karakterizohen nga çarje, plasaritje si edhe në ato raste kur janë të ekspozuara ndaj vibrimeve dhe tkurrje-bymimeve.
- I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave dhe paneleve të polisterolit mbi metal, dru dhe suporte me deformueshmëri të lartë.
- Gjithashtu FLEXIT rekomandohet të përdoret si elastifikues në të gjitha produktet me bazë çimento.

### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Tipi	Polimer akrilik në dispersion ujor
Ngjyra	E Bardhë
Viskoziteti	500±20mPa.s23°C
Densiteti	1,03 kg/lit

### MËNYRA E PËRDORIMIT DHE KONSUMI

#### Përgatitja e sipërfaqes

Sipërfaqet ku do të aplikohet ngjitësi duhet të jenë të pastra, pa vajra apo pluhura, rekomandohen të jenë sa më të sheshta. Në rastet kur nuk janë të tilla mund të nivelohen por duke shmangur gjithmonë akumulimin e ujit.

### ELASTIFIKIMI I NGJITËSAVE PËR PLLAKA

- Elastifikimi i plotë

Për (25 kg) DW (ngjitës pllakash) përzihen me 6 kg FLEXIT (nëse nevojitet mund të shtohet edhe një sasi 1-2 lt uji) duke u përzier vazhdimisht derisa të formohet një përzierje homogjene.

- Elastifikimi i pjesshëm për (25 kg) DW përzihet me 3-4 kg Flexit sëbashku me një sasi uji (afërsisht 3-4 kg), duke e përzier vazhdimisht derisa të fitohet një përzierje homogjene. Sipërfaqet poroze si, beton, gips etj., paraprakisht mund të trajtohen me një përzierje të flexit/ujin në raportin 1:2. Koha e tharjes për llaçrat dhe ngjitësat të cilët janë të përzier me Flexit, është dyfish më e madhe krahasuar me ngjitësat dhe llaçrat të cilët nuk janë përzier me Flexit. Ka edhe raste kur koha e tharjes mund të zgjasë më shumë se 3 ditë.

### RUATJA EDHE TEMPERATURA E APLIKIMIT

Produkti mund të ruhet për 18 muaj në paketim origjinal edhe në vend të thatë në temperatura nga +5°C deri në +35°C. Duhet të evitohet ekspozimi i produktit në temperatura të ulta (ngrica si edhe në temperatura të larta).

